

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 riformulohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji, si dhe të personave që rezultojnë se kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo denoncues që figurojnë në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit.

Neni 2

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Objekti

Objekti i këtij ligji është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike,

Forcave të Armatosura, organeve të rendit publik, sigurisë kombëtare dhe çdo institucioni apo entiteti tjetër ekonomik shtetëror, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji, si dhe të personave që rezultojnë se kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo denoncues që figurojnë në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit.

Neni 3

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Ndalimi për kandidim dhe ushtrimin e funksioneve të larta publike për efekt të ligjit nr.45/2015

1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët provohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, se kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo denoncues që figurojnë në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit.

2. Personat, për të cilët Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit provon se kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo denoncues që figurojnë në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit, nuk mund të emërohen apo zgjidhen në funksionet publike si më poshtë:

- a) në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj;
- b) gjyqtarë ose prokurorë;
- c) në postin e zëvendësministrit apo të njëvlershëm me të;
- ç) në postin e prefektit;
- d) funksionarë politikë në kabinetet e drejtuesve të çdo institucioni kushtetues apo të krijuar me ligj;
- dh) në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe shërbime të tjera informative;
- e) në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik si dhe drejtues të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil;
- ë) në Policinë e Shtetit;

f) ushtarakë të forcave të armatosura, si dhe

g) në çdo post drejtues të kompanive që zotërohen plotësisht apo në maxhorancë ose administrohen nga shteti.

3. Personave që janë duke ushtruar funksione të larta publike nga ato që përcaktohen në pikat 1 dhe 2 të këtij neni dhe provohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit se kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo denoncues që figurojnë në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit, u ndërpritet mandati dhe shkarkohen nga detyra për këtë shkak ligjor dhe sipas procedurës përkatëse të shkarkimit të përcaktuar nga neni 10 ose neni 13 i këtij ligji.

Neni 4

Në pikën 1 të nenit 4, pas fjalëve “të nenit 2” shtohen fjalët “dhe neni 3/1”

Neni 5

Në pikën 1 të nenit 5, shprehja “nenet 2 dhe 3” zëvendësohet nga shprehja “nenet 2, 3 dhe 3/1”

Neni 6

Titulli i nenit 8 riformulohet si vijon:

“Organi kompetent për verifikimin e zbatimit të ndalimeve sipas neneve 2 dhe 3 të këtij ligji”

Neni 7

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

Verifikimi i zbatimit të ndalimeve sipas nenit 3/1

Verifikimi i të dhënave për efekt të nenit 3/1 bëhet, me kërkesë të organit kompetent, nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Dispozita e nenit 8 të këtij ligji zbatohet njësoj edhe në këto raste.”

Neni 8

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Zbatimi i përcaktimeve të nenit 3/1 për funksionarët publikë aktualë

1. Funksionarët publikë që janë subjekt i këtij ligji, sipas përcaktimeve të nenit 3/1, të cilët janë aktualisht në detyrë, kryejnë vetëdeklarimin dhe e depozitojnë pranë organit kompetent, sipas këtij ligji, brenda 2 muajve nga miratimi i formularit të vetëdeklarimit nga Kuvendi. Verifikimi për herë të parë bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat për verifikim, të përcaktuara në këtë ligj.
2. Në rast refuzimi për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga ky ligj lidhur me integritetin, personi trajtohet sikur të ketë rezultuar në një nga rrethanat që përbën kusht për ndalim e zgjedhjes apo emërimit të tij në funksionin publik. Ndaj tij zbatohet masa e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.
3. Nëse provohet se ekzistojnë rrethanat për ndalimin e zgjedhjes apo emërimit, zbatohen procedurat e nevojshme kushtetuese apo ligjore për mbarimin e mandatit apo shkarkimin nga detyra.
4. Në rastet kur organet e ngarkuara nga Kushtetuta apo ligji për konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik, nuk veprojnë brenda 10 ditëve nga përfundimi i rezultateve të verifikimit, me kërkesë të 1/5 së deputetëve të Kuvendit, çështja i përcillet për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, e cila vendos konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik, kur plotësohen kushtet dhe rrethanat, sipas këtij ligji.”

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

LINDITA NIKOLLA

Miratuar në datën _____2022

RELACION SHPJEGUES

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE” “

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, është nisëm e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Kjo nisëm vjen në shërbim të qëllimit të vetë ligjit në fuqi që të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik jo vetëm të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, por edhe të personave që rezultojnë se kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo denoncues që figurojnë në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit.

Zbardhja e të vërtetës për personat që kërkojnë të ushtrojnë detyra shtetërore, mbi të gjitha për ata persona që kanë pasur dhe kanë detyra të larta shtetërore, qofshin të zgjedhur apo të emëruar, është jo vetëm një domosdoshmëri, por edhe një simbolikë e fuqishme për të dënuar krimet e të kaluarës dhe në funksion të së tashmes, për krijimin e një shoqërie të bazuar në parimet dhe vlerat demokratike dhe për pajtimin social.

Objekti i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, Forcave të Armatosura, organeve të rendit publik, sigurisë kombëtare dhe çdo institucioni apo entiteti tjetër ekonomik shtetëror, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikbërje dhe/ose vendimmarrje i personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji. Për t’u siguruar që historia të mos përsëritet dhe arrijen e paqes

sociale si dhe për të respektuar viktimat e regjimit totalitar, duhet që bashkëpunëtorët sekretë të sistemit të mëparshëm, punonjësit e ish siguimit të shtetit, të favorizuarit dhe denoncuesit në këto struktura e në shërbim të tyre, të mos të kenë mundësi të jenë pjesë e vendimarrjes i çfarëdo niveli qoftë ai.

Për këtë arsye nëpërmjet kësaj nisme, propozohet që subjekt i ligjit të jene edhe personat që rezultojnë se kanë qenë anwtar, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo denoncues që figurojnë në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit.

Nisma ligjore për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon ndalimin e personave për të marrë poste publike, nëse vërtetohet lidhja e tyre me shërbimet sekrete të regjimit të kaluar.

Verifikimi kryhet në bazë të vetëdeklarimit që kryen subjekti dhe nëse rezulton i pavërtetë, përveç humbjes së të drejtës për të qenë pjesë posteve publike, personi ngakohet dhe me përgjegjësi penale për deklaram të rremë.

Këtij detyrimi ligjor do t’i nënshtrohen jo vetëm ata që duan në të ardhmen të jenë pjesë e funksioneve shtetërore, por edhe atyre që janë aktualisht në pozicione të tilla, pavarësisht nëse e kanë apo jo një certifikatë pastërtie, Bezhani apo Mezini, pavarësisht nëse janë verifikuar më parë nga Autoriteti i Dosjeve apo jo.

Kjo nisëm së bashku me parashikimet e reja ligjore në ligjin e autoritetit të dosjeve dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor për verifikimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore, plotësojnë mozaikun ligjor, duke krijuar premisat e duhura ligjore që anëtarët, bashkëpunëtorët e sigurimit të shtetit, strukturave sekrete dhe spiunët e atij regjimi të mos jenë më pjesë e posteve publike e të mos mbajnë më peng të ardhmen e vendit për interesa të ngushta vetjake e në kundërshtim me parimet e shoqërisë demokratike.

Harmonizimi i kuadrit ligjor në këtë fushë, parandalon përfshirjen e këtyre individëve në ato pozicione zyrtare për të cilat ka arsye për të besuar se subjekti do të përbënte rrezik të madh për të drejtat e njeriut ose demokracinë, si zyrtarë shtetërorë me përgjegjësi të konsiderueshme për krijimin ose zbatimin e politikave qeveritare mbi sigurinë e brendshme, ose në organet e zbatimit të ligjit, sigurisë dhe inteligjencës, gjyqësori dhe prokuroria.

Në shumicën e vendeve post komuniste diktatoriale personat që kanë shërbyer në funksione politike në regjimet komuniste të këtyre vendeve, që kanë punuar në ‘policinë sekrete’ dhe forcat e shërbimit inteligjent, si dhe individët që kanë bashkëpunuar me këto shërbime, janë subjekte që i nënshtrohen procesit të verifikimit. Këtyre subjekteve i’u ndalohet të mbajnë pozicione politike dhe funksione drejtuese në administratën publike, si dhe në shërbimet e

inteligjencës dhe policisë. Për më tepër, në Hungari publikohen emrat e të gjithë personave që kanë qenë bashkëpunëtorë të strukturave represive të ish-regjimit komunist.

Këto ndryshime ligjore mundësojnë që historitë e së shkuarës të diskutohen hapur dhe në bazë të informimit të plotë e objektiv, ndalojnë personat me lidhje me ish sigurimin e shtetit që të jenë pjesë e vendimmarrjes publike dhe administratës shtetërore si dhe shërbejnë për të nxjerrë mësimet e dhura me qëllimin për të evituar përsëritjen dhe mbi të gjitha për të respektuar viktimat, të pafajshmit, dhe familjet shqiptare që përjetuan tragjedi përgjatë atij regjimi.